



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Himarë , më _____.____.2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksioni i rrugës Lagje Haliq Borsh (Plazh), Loti I”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233120-6 Punime
ndërtimi për rrugë

VLERA E FONDIT : **41,666,667** (dyzete e nje milion e gjashteqinde e gjashtedhjetë e gjashtë mijë
e gjashteqinde e gjashtedhjetë e shtatë) lekë **pa TVSH**

Perilogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimi / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha

kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 3,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024 dhe 2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti

për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*

- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

N.P-1. Punime gjurmimi në tokë

Klasifikimi A

N.P-2. Ndërtime civile e industriale;

Klasifikimi B

N.P-4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

Klasifikimi A

- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;

Klasifikimi A

N.S-18. Punime topogjeodezike

Klasifikimi A

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liqensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së liqensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Punime gërmim dheu, Punime prishje, Punime gërmim shkëmbi i fortësive të ndryshme me ekskavator	A	0-21 milion
NP-2	Ndërtime civile e industrial;	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin,	B	21-50 milion

		punime plotësuese dhe pajisje.		
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Shtresa rrugore dhe punime te tipologjise se rrugeve dytesore dhe/ose linja te punimeve	A	0-21 milion
NS-4	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	Rifiniture e muraturave te perfunduara	A	0-21 milion
NS-18	Punime topogjeodezike	Punime topogjeodezike	A	0-21 milion

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a) 1 (një) Inxhinier ndërtimi

b) 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit operatori ekonomik duhet të paraqesë:

• Diplomë, Kontratë pune, CV, Librezë Pune

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

** Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale. Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbljedhës të Vetëdeklarimit.*

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbljedhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbljedhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”*.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbljedhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbljedhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit,

jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv., me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve si dhe duke siguruar qwndrushemwrinw fizike tw konstruksioneve tw beton-armesw duke siguruar banesat dhe objektet e tjera tw cilat ndodhen nw gjatwsinw e segmentit.

Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ , i cili do të bëjë piktetimin e sakte të objektit dhe me pas vlerësimin topografik të tij, duke pasur në konsideratë vendndodhjen e vështirë të objektit.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) punojës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- b) Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(nje) punojës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ligjit Nr. 152/2015 "Per shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, Libreze pune si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajit e fundit

te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, Ose te sigurohet ng opertori ekonomik nepermjet kontrakimit.

Argumentimi: Ky kriter është i domosdoshëm për arsye të mëposhtme:

Garancia për sigurinë e jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe qytetarëve

Në ambientet e punës apo në vendin ku kryhen shërbimet, ekziston gjithmonë rreziku i ndodhjes së emergjencave, si aksidente, dëmtime fizike apo zjarre.

Prania e një punonjësi të specializuar garanton një reagim të menjëhershëm, të kualifikuar dhe të efektshëm, duke ndihmuar në shpëtimin e jetëve dhe minimizimin e pasojave. Përputhshmëria me kërkesat ligjore dhe standardet kombëtare/internacionale

Ky kriter bazohet në Ligjin Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, neni 49, pika 4, i cili përcakton qartë detyrimet e subjekteve private për të garantuar strukturat e nevojshme të sigurisë. Certifikata e kërkuar duhet të jetë lëshuar nga organizma të akredituar dhe të njohur nga Republika e Shqipërisë, çka siguron cilësinë dhe besueshmërinë e formimit profesional të individit.

Menaxhimi i riskut dhe përgjegjësia shoqërore Operatorët ekonomikë që ofrojnë shërbime apo kryejnë aktivitete në mjedise publike ose me rrezikshmëri të lartë kanë detyrimin moral dhe profesional për të menaxhuar riskun dhe për të siguruar gatishmërinë në rast incidentesh. Prania e një eksperti të certifikuar ndihmon në krijimin e një kulture sigurie dhe përgatitjes në situata emergjente. Kualifikimi i burimeve njerëzore si avantazh konkurues Ky kriter nxit punësimin e personelit të kualifikuar, si dhe promovon përfshirjen e trajnimeve cilësore si pjesë e strategjisë së përgjegjshme të kompanisë ndaj sigurisë.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë 1 (një) mjek të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. OE ofertues referuar Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësin që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, duket që ky kriter të plotësohet duke marrë në konsideratë numrin e punonjësëve në total, në zbatim të VKM-së Nr.108, datë

09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

- d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Librezë pune (përkatëse)
2. CV përkatëse
3. Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
4. Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a) Teknik ndertimi jo më pak se 2 (dy) punonjës; me deshmi te shkolles profesionale;
 - b) Teknik topograf 1 (nje), jo më pak se 1 (nje) punonjës; me deshmi te shkolles profesionale;
 - c) Hekurkthyes jo më pak se 2 (dy) punonjës; me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;
 - d) Murator, jo më pak se 1 (nje) punonjësme dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;
 - e) Specialist ndertimi jo më pak se 2 (dy) punonjës, me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;
 - f) Karpentier jo më pak se 2 (dy) punonjës; me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;
 - g) Shofer jo më pak se 2 (dy) punonjës; kontrate, me CAP & Leje Drejtimi;
 - h) Eskavatorist jo më pak se 2 (dy) punonjës; kontrate, me CAP & Leje Drejtimi;
 - i) Automakinist jo më pak se 2 (dy) punonjës; kontrate, me Dëshmi Aftesimi Profesional;
 - j) Eskavatorist jo më pak se 1 (nje) punonjës kontrate, me Dëshmi Aftesimi Profesional;
- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik i mesem Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik i mesem topograf**, referuar zerave te preventivit dhe projektit te miratuar, tekniku i mesem gjeodet se bashku me inxhinierin do te bejne pozicionimin korekt te objektit duke siguruar qe mbrojtja nga vershimet e perrenjeve te jete maksimale dhe objekti te kete funksionalitet te plote.
- **Karpentier**, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të analizave dhe preventivit.
- **Hekurkthyes**, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e duhur të punimeve të çatisë referuar zerave të analizave dhe preventivit.
- **Murator**, i specializuar ka njohuritë dhe përvojën për të siguruar që muret dhe strukturat të jenë ndërtuar sipas standardeve më të larta, referuar preventivit tëpunimeve, konkretisht kapitullit 10.

Specialist Ndërtimi, i nevojshëm për proceset e punës si : Analizimi i projektit: Specialistët studiojnë planin arkitektonik dhe specifikimet teknike për të kuptuar kërkesat dhe qëllimet e ndërtimit. Vlerësimi i materialeve dhe pajisjeve: Identifikohen materialet dhe mjetet e nevojshme për punë. Realizohet edhe një plan logjistik për transportin e tyre.

Përgatitja e hapësirës së punës: Pastrohet dhe nivelohet terreni ku do të realizohet ndërtimi, duke siguruar kushte optimale për punë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet jane te nevojshem per shkak te makinerive te ndryshme qe do te kryejne punime germimi, ngjeshje materiali etj.

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **30 (tridhjetë)** persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Vërtetuar me:

a. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën 3 muajt e fundit
Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 muajt e fundit, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **30 (tridhjetë)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, me koë të plotë pune ,është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë,drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.7 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, Kodi III.2.A (1+2) Auditim Mjedisor ndikim ne mjedis (Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne miedis. (Auditim mjedisor. Ndikim ne mjedis).

Argumentimi:

Kërkesa që operatorët ekonomikë të jenë të pajisur me licencë të lëshuar nga QKL (Qendra Kombëtare Licencave), me kodin III.2.A (1+2), përfshirë “Auditim Mjedisor” dhe “Ndikim në Mjedis”, është thelbësore për arsyet e mëposhtme:

Përmbushja e detyrimeve ligjore kombëtare në fushën e mjedisit Ligji shqiptar për mbrojtjen e mjedisit (Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, i ndryshuar) kërkon që vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe auditimi mjedisor të realizohen vetëm nga subjekte të licencuara dhe të specializuara. Kjo siguron që proceset teknike dhe dokumentacioni të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet kombëtare. Garantimi i cilësisë dhe besueshmërisë së analizave mjedisore Licenca është dëshmi që operatori ekonomik: Ka në përbërje ekspertë të certifikuar dhe të kualifikuar në fushën e mjedisit; Ka kapacitetet teknike, pajisjet dhe përvojën për të realizuar auditime dhe vlerësime reale, të paanshme dhe të dokumentuara siç duhet; Zbaton metodologji të njohura dhe të pranueshme ndërkombëtarisht për analizën e ndikimeve në mjedis. Mbështetje për vendimmarrjen e informuar dhe të qëndrueshme Vlerësimi i ndikimit në mjedis është një proces vendimtar për lejet mjedisore, planifikimin urban, ndërtimet, projektet infrastrukturore, etj. Operatorët pa licencë nuk kanë autoritetin ligjor ose kapacitetin për të përgatitur dokumente që do të përdoren në vendimmarrje me ndikim publik apo ekologjik. Prania e kësaj licence siguron që rezultatet e auditimit janë të vlefshme për institucionet publike dhe komunitetin. Mbështetja e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjshmërisë mjedisore Kërkesa për licencë nxit përfshirjen e kompanive me vetëdije mjedisore dhe kompetencë profesionale në projektet publike apo private. Kjo përputhet me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm, ruajtje të biodiversitetit dhe ulje të ndikimeve negative në mjedis.

2.3.8 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi:

Përmbushja e detyrimeve ligjore dhe rregullatore

Ky kriter bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, i ndryshuar, i cili rregullon aktivitetet që kërkojnë licencim përmes Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL). Veprimtaria e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve inerte dhe të ngurta është një aktivitet me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis dhe nuk mund të ushtrohet pa licencë të posaçme, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi. Sigurimi i një menaxhimi të kontrolluar dhe të përgjegjshëm të mbetjeve Mbetjet inerte dhe të ngurta (si mbeturina ndërtimi, prishje objektesh, materiale të ngurta urbane etj.) paraqesin rrezik të ndotjes mjedisore nëse nuk trajtohen në mënyrë të duhur. Operatorët e pajisur me licencë tregojnë se: Kanë kapacitete teknike (automjete, kontejnerë, logjistikë); Kanë strukturë organizative dhe trajnim për stafin; Veprojnë sipas një skeme të miratuar dhe të gjurmuar të menaxhimit të mbetjeve. Garanci për mbrojtjen e

mjedisit dhe shëndetit publk. Mbetjet inerte të depozituara apo transportuara në mënyrë të pakontrolluar ndikojnë negativisht në: Tokën, ujërat nëntokësore dhe ajrin; Higjienën urbane dhe shëndetin e komunitetit. Operatorët e licencuar janë të detyruar të respektojnë rrugë të miratuara për transportin, vendgrumbullime të autorizuar dhe procedura të sigurisë, duke ofruar mbikëqyrje dhe transparencë. Barazi në garë dhe kontroll i aktivitetit ekonomik Ky kriter ndihmon në parandalimin e konkurrencës së padrejtë nga subjektet jo të licencuara që mund të veprojnë në mënyrë informale ose pa përgjegjësi ligjore. Një licencë e tillë është dëshmi që operatori është i regjistruar, i kontrolluar dhe i mbikëqyrur nga autoritetet kompetente, duke garantuar një nivel minimal sigurie dhe përputhshmërie me ligjin.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion veteshkarkues deri ne 10 ton	2 copë	Pronesi ose me qera
Kamion veteshkarkues deri ne 20 ton	2 copë	Pronesi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhira	1 copë	Pronesi ose me qera
Afaltoshtruese	1 copë	Pronesi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronesi ose me qera
Minifadrome	1 copë	Pronesi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronesi ose me qera
Bitumatrice	1 copë	Pronesi ose me qera
Rrul Gome-Hekur deri ne 16 t	1 copë	Pronesi ose me qera
Rrul Hekur-Hekur deri ne 16 t	2 copë	Pronesi ose me qera
Gjenerator energjie elektrike 270 kva	1 cope	Pronesi ose me qera
Depozite Uji 5000 lit	2 copë	Pronesi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronesi ose me qera
Vibrator siperfaqesor dhe thellesie	2 copë	Pronesi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronesi ose me qera
Autopompë betoni	1 copë	Pronesi ose me qera
Nyje prodhimi të inerteve, me leje mjedisore Tipi B III.1.B “Impiant fraksionimi te inerteve te gurit gelqeror” dhe me leje mjedisore Kodi III.1B ‘Nxjerja mineraleve reres argjiles nga mineralet ne qiell te hapur dhe nga gurroret” te gjitha me afat vlefshmerie, brenda kohes se zbatimit te projektit dhe Brenda territorit te Bashkise Himare”	1 copë	Pronesi ose me qera, ose me kontratë furnizimi
Nyje prodhimi betoni, leje mjedisore Tipi B III.1.B, ne largesi deri 50 km nga vendi ndertimit	1 copë	Pronesi ose me qera, ose me kontratë furnizimi
Nyje prodhimi asfalti, leje mjedisore Tipi B III.1.B, ne largesi deri 50 km nga vendi ndertimit	1 copë	Pronesi ose me qera, ose me kontratë furnizimi
Kokore minimum	20 copë	Pronesi ose me qera
Rripa lidhës sigurimi minimum	20 copë	Pronesi ose me qera
Fikëse zjarri minimum	20 copë	Pronesi ose me qera
Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi	20 copë	Pronesi ose me qera
Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi	20 copë	Pronesi ose me qera

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomikë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomikë u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

- Autobetoniere, e nevojshme për betonime të strukturave të armuara sipas manualit Nr 3.240, 3.205, 3.247
 - Betoniere Kantieri, e nevojshme për betonime të strukturave të armuara sipas manualit Nr 3.240, 3.205, 3.247
 - Ekskavator me zinxhire, referuar kapitullit 5, punime germimi
 - Fadrome me goma, e nevojshme për punë dhe sisteme në hapësira të ngushta
 - Grejder, i nevojshëm për përhapjen e njetratjeshëm të shtresave përgjate gjithë segmentit
 - Asfaltoshtruese, për shtrimin e asfaltit dhe binderit
 - Ekskavator me goma, referuar manualit nr 3.47/1b
 - Rrull gome hekur min 16 ton, i nevojshëm për ngjeshjen e shtresave në kombinim me grejderin dhe mjete të tjera teknologjike
 - Rrull ngjeshës hekur hekur min 16 ton, i nevojshëm për ngjeshjen e shtresave në kombinim me grejderin dhe mjete të tjera teknologjike,
 - Vibrator betoni i jashtëm, për betonimin e strukturave të armuara
- Moto gjenerator, për funksionimin e pajisjeve që kanë nevojë për rrymë elektrike në kantiere

Argumetimi teknik për distancën e transportit të betonit Distanca prej 50 km nga objekti argumentohet bazuar në qendrueshmërinë (viskozitetin) e materialit të betonit i cili duhet të ruajë parametrat teknik përpara hedhjes në veprë. Nëse distanca e transportit të betonit do të jetë më e madhe se 60 min deri në veprë, kjo do të krijonte dëmtim të materialit. Me planvendosje/genplan për të treguar me saktësiht që largësia e kërkuar është e saktë.

Argumetimi teknik për distancën e transportit të asfaltobetonit Distanca prej 50 km nga objekti argumentohet bazuar në qendrueshmërinë (viskozitetin) e materialit të betonit i cili duhet të ruajë parametrat teknik përpara hedhjes në veprë. Nëse distanca e transportit të betonit do të jetë më e madhe se 60 min deri në veprë, kjo do të krijonte dëmtim të materialit. Me planvendosje/genplan për të treguar me saktësiht që largësia e kërkuar është e saktë.

Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Certifikate: EN ISO 9001: 2015 Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente ;
- Certifikate: EN ISO 14001:2015 Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ose ekuivalente;
- Certifikate: ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë) ose ekuivalente;
- Certifikate: ISO 39001: 2012 (Për sistemin e menaxhimit të sigurisë për trafikun rrugor) ose ekuivalente;
- Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të

konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor,gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- ISO 39001:2012 (Sistem i Menaxhimi i sigurise se Trafikut Rrugor) Ne vleresimin e AK shihet e nevojsheme pasja e certifikimit ne lidhje me Sistem i Menaxhimi i sigurise se Trafikut Rrugor duke pasur parasysh se ky objekt ne pjesen me te madhe te gjatesise se tij shtrihet pergjat aksit Bypss te qytetit, duke konsideruar pranine e mjeteve te renda teknike te cilat do te hyjne dhe dalin ne kantier dhe objekt, AK kerkon standartine mbrojtjes se perdorueseve te rruges gjate punimeve ne kete objekt.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky qe përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikat

më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shendetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

NJESIA E PROKURIMIT